

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7971
E premte, 17 janar 2025
Çmimi 0.50 €

ShBA-ja lejon blerjen e
helikopterëve "Black Hawk"
për FSK-në | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MIJËRA EURO DËNIME PËR SHKELJEN E KODIT TË MIRËSJELLJES GJATË FUSHATËS



Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) i ka shqiptuar gjobat e para për shkelje të Kodit të Mirësjelljes pesë ditë pas hapjes së fushatës për zgjedhjet e 9 shkurtit. PZAP-

ja ka gjobitur me mijëra euro LDK-në, AAK-në dhe LV-në. Partitë e gjobitura kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën Supreme lidhur me vendimet e PZAP-së. Flutura Kusari, këshilltare ligjore në

Qendrën Evropiane për Liri të Shtypit dhe Medias, tha të enjten se vendimet e PZAP-së do të krijojnë një lloj precedenti dhe standardi për të ardhmen në fushën e shprehjeve politike

THEKSOHET RËNDËSIA E VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE TË 9 SHKURTIT NGA EKIPI I MISIONIT VËZHGUES TË ZGJEDHJEVE TË BE-së



IKD-ja: QEVERIA TA RISHIKOJË DRAFT-STRATEGJINË KUNDËR KORRUPSIONIT



OPINION

ZGJEDHJET NË KOSOVË,
SFIDË E MADHE PËR QEVERINË
DHE PËR OPOZITËN | F. 6

Shkruan:
Fadil MALOKU



AKTUALE



BIDENI FLET PËR RREZIQET NDAJ
DEMOKRACISË AMERIKANE
NË FJALIMIN E LAMTUMIRËS | F. 2

KOMF: MOS I SHFRYTËZONI FËMIJËT
NË FUSHATË ZGJEDHORE! | F. 5

EKONOMI



ME PAGË NËN MINIMALE, PUNËTORËT
E SIGURIMIT DHE TË MIRËBAJTJES
SHKELEN NË INSTITUCIONE | F. 8

QEVERIA MIRATON PROGRAMIN PËR
REFORMA NË EKONOMI 2025-2027

SPORT



VËLLAZNIMI ZËVENDËSON LEOTRIM
KRASNIQIN ME MIREL JOSËN | F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni flet për rreziqet ndaj demokracisë amerikane në fjalimin e lamtumirës

WASHINGTON, 16 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, iu drejtua kombit me një fjalim lamtumirë mbrëmjen e së mërkurës, duke paralajmëruar se një "oligarki e rrezikshme" e njerëzve jashtëzakonisht të pasur po formësohet në Amerikë, e cila zotëron pushtet dhe ndikim që kërcënojnë demokracinë. "Jam i shqetësuar për rënien e rrezikshme të pushtetit në duart e ca njerëzve të pasur", tha Biden, duke folur nga Shtëpia e Bardhë. Ai tha se përqendrimi i pasurisë në duart e pak vetave, nuk e kërcënon vetëm demokracinë, por edhe të drejtat dhe liritë themelore, si dhe pritjet se çdo njeri meriton një "mundësi të barabartë" për të arritur sukses. Pasi ta përfundojë mandatin e tij, Biden do të largohet nga Shtëpia e Bardhë më 20 janar, dhe do të pasohet nga presidenti i zgjedhur, Donald Trump, i cili është miliardë dhe ka mbështetjen e shefit të Teslas dhe SpaceX, Elon Musk, njeriut më të pasur në botë,

si dhe të njerëzve të tjerë jashtëzakonisht të pasur. Musk, i cili ndjek të njëjtën vijë të politikës së djathtë si Trumpi, i shpenzoi dhjetëra miliona dollarë për ta ndihmuar fushatën presidenciale të Trumpit vitin e kaluar dhe do të marrë pjesë në inaugurimin e tij. Dy miliardë të tjerë të njohur amerikanë – themeluesi i Amazonit, Jeff Bezos, dhe bashkëthemeluesi i Facebookut dhe shefi i Metas, Mark Zuckerberg – gjithashtu pritet të marrin pjesë në inaugurimin e Trumpit. Biden përmendi disa nga arritjet e tij, përfshirë drejtimin e vendit për të dalë nga pandemia e koronavirusit gjatë dy vjetëve të tij të para si president, mbështetjen për prodhimin vendas dhe kufizimin e çmimit të barnave të përshkruara. Por, Biden tha se vlerat amerikane janë duke u "sprovuar vazhdimisht", duke paralajmëruar për ngritjen e mundshme të asaj



që ai e quajti "kompleksi industrial i teknologjisë" dhe të ardhmen e inteligjencës artificiale. "Amerikanët po varrosen nën një ortek dezinformimesh dhe keqinformimesh, që mundësojnë abuzimin me pushtetin", tha ai. "Shtypi i lirë po shembet. Redaktorët po zhduken. Mediat sociale po heqin dorë nga verifikimi i fakteve. E vërteta po mbytet nga gënjeshttrat për pushtet dhe për përfitime", theksoi ai. Ai nënvizoi se, për t'i luftuar këto prirje, platformat e mediave

sociale duhet të mbajnë përgjegjësi për t'i mbrojtur fëmijët, familjet dhe demokracinë amerikane nga abuzimi me pushtetin. Inteligjenca Artificiale (IA), sipas tij, është një zhvillim që ka potencialin për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve, madje edhe për të gjetur një shërim për kancerin, por në të njëjtën kohë mund edhe të "shkaktojë kërcënime të reja për të drejtat tona, mënyrën tonë të jetesës, privatësinë tonë, mënyrën se si punojmë dhe si e mbrojmë

kombin tonë". "Inteligjenca Artificiale është teknologjia më domethënëse e kohës sonë, ndoshta e të gjitha kohërave. Asgjë nuk ofron më shumë mundësi dhe rreziqe të mëdha për ekonominë, sigurinë, shoqërinë tonë dhe për njerëzimin", tha ai. Megjithatë, ajo duhet të jetë "e sigurt, e besueshme dhe e dobishme për mbarë njerëzimin", shtoi ai, duke theksuar se është më e rëndësishme se kurrë që "si tokë e lirisë, Amerika, dhe jo Kina, ta udhëheqë botën në zhvillimin e IA-së". Biden, i cili e mundi Trumpin në zgjedhjet presidenciale të vitit 2020, do të largohet nga detyra javën e ardhshme, pasi u tërhoq për shkak të shqetësimeve në lidhje me aftësinë e tij mendore, duke i hapur rrugën nënpresidentes Kamala Harris që të garonte kundër Trumpit si kandidatja e Partisë Demokratike në zgjedhjet e vitit 2024. Harris humbi përballë Trumpit në zgjedhjet e 5 nëntorit.

Izraeli dhe Hamasi arrijnë marrëveshje për armëpushim dhe pengje

TEL AVIV, 16 JANAR - Izraeli dhe Hamasi kanë arritur marrëveshje të mërkurën për ndaljen e luftimeve në Rripin e Gazës dhe për këmbimin e pengjeve izraelite me të burgosur palestinezë. Presidenti amerikan në shkuarje, Joe Biden, tha në një komunikatë se marrëveshja për armëpushim dhe lirinë e pengjeve izraelite do t'u japë fund luftimeve 15-mujore në Gazë, si dhe do ta mundësojë rritjen e ndihmave humanitare për civilët palestinezë. "Ky është rezultat jo vetëm i trysnisë ekstreme me të cilën është përballur Hamasi, dhe ndryshimeve në rajon pas një armëpushimi në Liban dhe dobësimit të Iranit - por edhe i



diplomacisë së palodhshme dhe të mundimshme amerikane. Diplomacia ime nuk ka pushuar asnjëherë në përpjekjet për ta arritur këtë", tha Biden. Biden tha se armëpushimi

gjashtëjavor do të mundësojë negociatën për të arritur një fund të përhershëm të luftës. Ai shtoi se, nëse negociatat do të zgjasin më shumë se gjashtë javë, armëpushimi do të vazhdojë për aq kohë sa

bisedimet do të vazhdojnë. Marrëveshja pason muaj negociatash me ndërprerje, të cilat u ndërmjetësuan nga Egjipti dhe Katari, me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara, dhe u arrit pak para inaugurimit të presidentit të zgjedhur të ShBA-së, Donald Trump, më 20 janar. Biden theksoi se administrata e tij ka negociuar marrëveshjen, por ekipi i Trumpit do të ngarkohet së shpejti me detyrë e mbikëqyrjes së zbatimit të saj. Dërguari i Trumpit për Lindjen e Mesme, Steve Witkoff, ishte bashkuar me këshilltarin e Lindjes së Mesme të Shtëpisë së Bardhë, Brett McGurk, për finalizimin e negociatave në Doha. "Në ditët e

fundit, ne kemi folur si një ekip i vetëm", tha Biden. Kryeministri i Katarit, Mohammed bin Abdulrahman Al Thani, njoftoi se marrëveshja do të hyjë në fuqi më 19 janar. Më herët, zyra e kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu tha se marrëveshja për armëpushim me Hamasin nuk është arritur ende dhe se është duke u vendosur për hollësitë e fundit të saj. Në një komunikatë ajo tha se shpreson se "hollësitë do të zgjidhen në orët në vijim". Hamasi - i cili është i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - nuk është deklaruar ende.

Shefi i inteligjencës finlandeze bën thirrje për rritje të vigjilencës për shkak të Ruisë

HELSINKI, 16 JANAR - Reformat e planifikuara në ushtrinë ruse, përkatësisht rritja e numrit të ushtarëve për 30 për qind, paraqesin kërcënim për NATO-n dhe për këtë duhet të rritet vigjilanca. Kështu tha më 16 janar shefi i shërbimit të inteligjencës ushtarake të Finlandës, Pekka Turunen. Finlanda, që ndan kufirin më të gjatë që Bashkimi Evropian ka me Rusinë, iu bashkua aleancës ushtarake perëndimore të NATO-s më

2023. Pas saj, edhe Suedia fjinje iu bashkua aleancës në mars 2024. Që të dy shtetet nordike bënë këtë hap në përgjigje të nisjes së pushtimit rus të Ukrainës. Shërbimi i inteligjencës ushtarake, që udhëhiqet nga Turunen, në rishikimin vjetor të publikuar të enjten, tha se Moska ka njoftuar se planifikon të bëjë reforma në ushtrinë e saj në fund të vitit 2026. "Po, ky është kërcënim për



NATO-n, veçmas nëse ky plan zbatohet", tha Turunen për Reuters, duke shtuar se ai

mendon se Rusia ka gjasa reale që të arrijë qëllimet e saj deri në vitin 2030. "Ne duhet të reagojmë, në kuptimin që ne na duhet të jemi më vigjilentë". Ministria e Mbrojtjes së Ruisë tha dhjetorin e vitit të kaluar se Moska duhet të jetë e gatshme që të luftojë me NATO-n në Evropë në dekadën e ardhshme. Presidenti rus, Vladimir Putin, duke folur në të njëjtin takim, deklaroi se udhëheqësit perëndimorë "thjesht po e frikësojnë

popullatën e tyre se ne do të sulmojmë dikë, duke përdorur pretekstin e kërcënimit mitik rus". Turunen tha se Rusia synon të rrisë për 30 për qind numrin e trupave të saj, që do të bënte që numri i përgjithshëm i ushtarëve të arrinte në 1.5 milion. Numri i ushtarëve rusë të vendosur në afërsi të Finlandës mund të dyfishohet apo trefishohet krahasuar me periudhën para nisjes së luftës në Ukrainë, tha Turunen.

ShBA lejon blerjen e helikopterëve “Black Hawk” për FSK-në

PRISHTINE, 16 JANAR - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) i kanë dhënë dritën e gjelbër Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) për blerjen e helikopterëve ushtarakë “Black Hawk”. Kjo u bë me dije nga ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, gjatë një vizite në ShBA. “Në fazën e tretë të tranzicionit ku do të kërkohen sisteme më të avancuara sidomos të mbështetjes ushtarake, që nënkupton helikopterë radarë të mbrojtjes ajrore. Dhe kemi marrë mbështetje që Shtetet e Bashkuara të Amerikës do ta mbështesin Republikën e Kosovës në ndërtimin e këtyre kapaciteteve”, ka deklaruar Maqedonci.

Ministri i bëri një vizitë edhe fabrikës “Sikorsky - Lockheed Martin”, ku prodhohen helikopterë të ndryshëm, ndër të cilët edhe helikopterët “Black Hawk”. Përveç helikopterëve, FSK këtë vit do të furnizohet edhe me pajisjen anti-tank “Javelin” - me një numër të konsiderueshëm prej tyre. Lidhur me këtë hap të rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve ushtarake të Kosovës, drejtori i Institutit Octopus, Arben Fetoshi, ka thënë për “Telegrafi”-n se kjo është arritja më e madhe e Kosovës. Fetoshi thekson se ky hap është një element kyç në procesin e zhvillimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), i cili përforcon aftësitë e saj për



tëambrojtur vendin dhe rajonin. “Avancimi i kapaciteteve të FSK-së me helikopterët amerikanë ‘Black Hawk’ është një zhvillim tejet i rëndësishëm për konsolidimin e ushtrisë së Kosovës”, ka thënë Fetoshi, duke shtuar se “veprimet e koordinuara me partnerët e NATO-s në tranzicionin e FSK-së, jo vetëm që i kanë demantuar skeptikët, por janë konfirmuar si domosdoshmëri

për ngritjen e aftësive mbrojtëse në një mjedis gjithnjë e më të sfiduar të sigurisë”.

Fetoshi ka vlerësuar se kalimi në fazën finale të zhvillimit të FSK-së, me fokus në sistemin e mbrojtjes ajrore, është një hap i rëndësishëm në këtë proces. Ai ka theksuar se “përmbyllja e fazës së dytë me kapacitetet e plota luftarake të këmbësorisë, sistemet e armatimit të rëndë dhe pajisjet e sofistikuara, i mundëson FSK-së kalimin në fazën finale të zhvillimit me sistemin e mbrojtjes ajrore”.

Drejtori i Institutit Octopus më tutje ka shtuar se ky zhvillim ka një rëndësi të madhe për afirmimin ndërkombëtar të Kosovës, duke shtuar se miratimi i helikopterëve “Black Hawk” nga Shtetet e Bashkuara është arritja më e madhe e Kosovës jo vetëm për aftësimin e saj për mbrojtje nga kërcënimet e jashtme, por edhe për afirmimin ndërkombëtar si faktor ndërveprimi me aleatët për paqen dhe sigurinë në botë. Përveç kësaj, Fetoshi ka nënvizuar se Kosova ka dëshmuar përgjegjësi dhe angazhim konstruktiv në stabilitetin rajonal, pavarësisht prej provokimeve dhe sulmeve të vazhdueshme nga Serbia. Ai ka theksuar se mbështetja e vazhdueshme nga partnerët si ShBA-ja, Britania e Madhe,

Gjermania dhe Turqia ka siguruar një forcë moderne sipas standardeve të NATO-s. “Tranzicioni i koordinuar dhe mbështetur nga aleatët kryesorë jo vetëm që ka siguruar ndërtimin e një force moderne sipas standardeve të NATO-s, por po ashtu i ka neutralizuar ‘shqetësimet’ dhe zërat kundërshtues për FSK-në,” ka shtuar Fetoshi.

Në kontekstin e zhvillimeve të fundit ai ka theksuar se kërcënimet reale për sigurinë që ka shkaktuar agresioni i Rusisë në Ukrainë, kanë imponuar një dinamikë të re në priorizimin e sigurisë. “Duke pasur parasysh specifikat e veriut të Kosovës dhe në kuadrin e bashkëveprimit me misionin e NATO-s, nuk mendoj se do të ketë pengesa. Në raport me Serbinë, ndërtimi i kapaciteteve të mbrojtjes ajrore është edhe një mesazh i qartë për realitetin tonë fqinjësor, të cilin, sa më parë që e pranon, do të jetë në të mirën e përbashkët të dy vendeve dhe të rajonit në përgjithësi”, tha Fetoshi për Telegrafin.

Fetoshi ka theksuar se integrimi sa më i shpejtë i Kosovës në NATO është përgjigjja më e mirë ndaj kërcënimeve hibride dhe qëllimeve ruse në rajon. Ai thekson se blerja e helikopterëve si hapi më i rëndësishëm në ngritjen e sistemit të mbrojtjes

ajrore, do ta përforcojë Kosovën si faktor të paqes në Ballkanin Perëndimor. “Duke pasur parasysh rrezikun e vazhdueshëm të ndikimit rus nëpërmjet Serbisë dhe Bosnjë-Hercegovinës si shtete jashtë NATO-s, tranzicioni i FSK-së në forcë mbrojtëse do t’i rriste kapacitetet e saj për parandalimin e ndërhyrjeve malinje kundër interesave strategjike të Perëndimit. Për këtë arsye, integrimi sa më i shpejtë në NATO do të ishte përgjigjja më e mirë ndaj kërcënimeve hibride dhe qëllimeve ruse në rajon”, u shpreh Fetoshi.

Fetoshi tutje ka deklaruar se një përfshirje më e madhe siç do ishte ‘Partneriteti për Paqe’ fillimisht dhe një rritje presioni mbi Serbinë për ta pranuar realitetin me Kosovën e pavarur, përveçse do ta forconte sigurinë rajonale, do të garantonte mbushjen e boshllëkut që Rusia po tenton vazhdimisht ta shfrytëzojë për qëllimet e veta kundër Perëndimit. Në përfundim, Fetoshi ka vlerësuar se tranzicioni i FSK-së është një hap i rëndësishëm për ta garantuar përkatesinë euroatlantike të Kosovës. “Tranzicioni i FSK-së është rruga që etablon përkatesinë euroatlantike të Kosovës,” ka përfunduar ai.

Çfarë janë helikopterët “Black Hawk”?

Helikopterët “Black Hawk” janë helikopterë ushtarakë shumëfunksionalë të prodhuar nga kompania amerikane “Sikorsky Aircraft” dhe janë përdorur gjerësisht nga ushtritë e shumë vendeve të botës.

Disa specifika kyçe për helikopterët “Black Hawk” janë: Transporti i trupave, evakuimi, kërkim-shpëtimi, mbështetja ajrore me armë, transporti i ngarkesave. Mund të transportojë deri në 11 ushtarë të armatosur, ose 2 600 kg ngarkesë të pajisjeve dhe armëve. Ka një sistem të avancuar navigimi dhe komunikimi. Funkcionon me

dy motorë. Mund të pajiset me armë automatike dhe raketa, si dhe mund të mbajë deri në dy mitralozë për mbrojtje.

“Black Hawk” është përdorur për dekada nga ushtria amerikane, si dhe nga shumë aleatë të saj, përfshirë shumë shtete të NATO-s. Helikopterët “Black Hawk” janë të njohur për qëndrueshmërinë e tyre, fleksibilitetin dhe aftësitë e shumta që mundësojnë operacione të ndryshme ushtarake, duke e bërë këtë model të një helikopteri kyç në arsenalin e ushtrive moderne.

Zyrtarët policorë pajisen me kartela xhepi për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara

PRISHTINE, 16 JANAR - Në kuadër të përkushtimit për ofrimin e sigurisë gjithëpërfshirëse, Policia e Kosovës (PK) ka bërë një hap të rëndësishëm për trajtimin e personave me aftësi të kufizuara.

Më 15 janar 2025, në një ceremoni të veçantë, PK ka pranuar 8 000 kartela xhepi nga

OSBE-ja, të cilat do t’i ndihmojnë zyrtarët policorë për trajtimin profesional të rasteve që përfshijnë këtë kategori qytetarësh.

Kartelat janë të ndara në gjuhën shqipe (7000), serbe (1000) dhe angleze (40), dhe do të shpërndahen te zyrtarët hetues, sektorialë dhe reagues.

Këto kartela do ta ndihmojnë punën e Policisë së Kosovës për përmirësimin e shërbimeve ndaj komunitetit.

Ky projekt u realizua falë bashkëpunimit me OSBE-në, duke forcuar përkushtimin e PK-së për profesionalizëm dhe gjithëpërfshirje në shërbimet ndaj qytetarëve.





Mijëra euro dënime për shkeljen e Kodit të Mirësjelljes gjatë fushatës

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) i ka shqiptuar gjobat e para për shkelje të Kodit të Mirësjelljes pesë ditë pas hapjes së fushatës për zgjedhjet e 9 shkurtit. PZAP-ja ka gjobitur me mijëra euro LDK-në, AAK-në dhe LV-në. Partitë e gjobitura kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën Supreme lidhur me vendimet e PZAP-së. Flutura Kusari, këshilltare ligjore në Qendrën Evropiane për Liri të Shtypit dhe Medias, tha të enjten se vendimet e PZAP-së do të krijojnë një lloj precedenti dhe standardi për të ardhmen në fushën e shprehjeve politike

PRISHTINË, 16 JANAR - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) i ka shqiptuar gjobat e para për shkelje të Kodit të Mirësjelljes pesë ditë pas hapjes së fushatës për zgjedhjet e 9 shkurtit. PZAP-ja ka gjobitur me mijëra euro Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK), Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lëvizjen Vetëvendosje (LV). LDK-ja u gjobit më 15 janar me 20 000 euro për gjuhë të urrejtjes, pasi kandidatja e saj për deputete, Xheneta Syka, e

publikoi në llogarinë e vet në "Facebook" një video ku kryeministri i Kosovës, Albin Kurti i LV-së, krahasohej me Adolf Hitlerin. PZAP-ja tha se paneli hulumtues i saj ka gjetur se me qëllim të etiketimit të LV-së dhe të promovimit të LDK-së, Syka ka nxitur "urrejtje" ndaj partisë së kryeministrit Kurti. Ajo tha se me këtë, LDK-ja e ka shkelur nenin 34 të Ligjit për Zgjedhjet, i cili ua ndalon partive politike, kandidatëve dhe mbështetësve të tyre, përdorimin e gjuhës së

urrejtjes - e cila mund ta nxisë apo provokojë një person tjetër të kryejë akte dhune kundër të tjerëve - si dhe përdorimin e fotografive, simboleve dhe materialeve të tjera që kanë ose mund të kenë ndikim të tillë.

Ky vendim pasoi ankesën që LV-ja e kishte bërë në PZAP, organ ky që e urdhëron LDK-në ta paguajë gjobën brenda një afati prej 15 ditëve.

PZAP-ja e gjobiti edhe Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) me 12 000 euro më 15 janar, pas një ankesë të Lëvizjes Vetëvendosje se kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, kishte bërë akuza të pabaza dhe të pavërtetuara kundrejt kryeministrit Kurti, ashtu si edhe kandidati për deputet i AAK-së, Ardian Gjini. Paneli tha se Haradinaj dhe Gjini kanë nxitur "urrejtje" ndaj kryeministrit Kurti duke përdorur gjuhë denigruese dhe urrejtëse, pasi kishin thënë se "duhet ta heqim mashtruesin" dhe se "nuk duam më lojëra me sigurinë kombëtare pas shpinës së aleatëve tanë e në interes të Serbisë e Ruisë nga argati i tyre".

PZAP-ja e gjobiti edhe Lëvizjen Vetëvendosje me 3 000 euro për shkelje të Ligjit për Zgjedhjet pas ankesës së LDK-së. Në njoftimin për medie, PZAP-ja tha se kandidati për kryeministër i LV-së për zgjedhjet e 9 shkurtit, Albin Kurti, ka përdorur gjuhë fyese dhe denigruese "duke nxitur urrejtje" ndaj Lidhjes Demokratike të Kosovës gjatë një tubimi zgjedhor në Pejë më 13 janar.

Partitë e gjobitura kanë të drejtë të ankohen në Gjykatën Supreme lidhur me vendimet e PZAP-së.

Flutura Kusari, këshilltare ligjore në Qendrën Evropiane për Liri të Shtypit dhe Medias, tha të enjten se vendimet e PZAP-së do të krijojnë një lloj precedenti dhe standardi për të ardhmen në fushën e shprehjeve politike. "Asnjë politikan në Kosovë nuk duhet të krahasohet në asnjë formë me Hitlerin. Ky krahasim dhe kjo shprehje nuk është liri e shprehjes. Është abuzim me lirinë e shprehjes", shkroi ajo në një postim në rrjetin social "Facebook".

Në zgjedhjet parlamentare të 9

shkurtit në Kosovë do të garojnë 28 subjekte politike me gjithsej 1 280 kandidatë. Më shumë se 2 milionë njerëz brenda dhe jashtë Kosovës kanë të drejtë vote në këto zgjedhje.

Në fletëvotim votuesit do të mund të zgjedhin një subjekt politik dhe deri në dhjetë kandidatë për deputetë. Ky është një ndryshim pas miratimit të Ligjit të ri për Zgjedhjet. Në të kaluarën qytetarët kanë pasur mundësinë të zgjedhin deri në pesë kandidatë.

Secila parti e certifikuar mund të ketë deri në 110 kandidatë në listën zgjedhore.

Nga këto lista do të zgjidhet përbërja e re e Kuvendit me 120 ulëse dhe deputetët më pas zgjedhin qeverinë e re. Qeveria aktuale në Kosovë udhëhiqet nga Albin Kurti, kreu i Lëvizjes Vetëvendosje. Fushata zgjedhore filloi më 11 janar dhe për një muaj, partitë dhe kandidatët do të tentojnë t'i bindin votuesit që t'i zgjedhin ata.

Këto janë zgjedhjet e para të rregullta që Kosova mban që nga shpallja e pavarësisë më 2008.

Theksohet rëndësia e vëzhgimit të zgjedhjeve të 9 shkurtit nga Ekipi i Misionit Vëzhgues të Zgjedhjeve të BE-së

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 16 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim ekipin e Misionit Vëzhgues të Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian, të kryesuar nga Nathalie Loiseau, njëherësh deputete e Parlamentit Evropian. Ky takim është zhvilluar në kuadër të angazhimeve të përbashkëta për të siguruar një proces zgjedhor të lirë, të ndershëm dhe demokratik në zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë.

Gjatë takimit presidentja Osmani dhe kryesuesja Loiseau diskutuan për rëndësinë e një procesi zgjedhor të lirë, të ndershëm dhe transparent, duke nënvizuar se Kosova tashmë ka dëshmuar përkushtimin për organizimin e zgjedhjeve demokratike.

Presidentja Osmani nëpërmes një letre të dërguar më 3 shtator 2024 përfaqësuesit të lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, ka kërkuar dërgimin e një Misioni të Vëzhgimit të Zgjedhjeve. Në këtë kontekst, presidentja Osmani shprehu mirënjohjen për angazhimin e vazhdueshëm të BE-së në mbështetje të demokracisë në Kosovë dhe rikujtoi rëndësinë e misioneve vëzhguese të BE-së që nga viti 2013.

Ajo theksoi se këto janë zgjedhjet e para të rregullta sipas Ligjit të ri për Zgjedhjet e Përgjithshme, duke i dhënë një dimension të ri procesit zgjedhor në vend.

Në takim me Loiseau, presidentja Osmani ka ritheksuar kërkesën e bërë edhe në letrën dërguar Borrellit, në mënyrë që ky mision të përfshijë

një fokus të veçantë në përfaqësimin e grave në të gjitha fazat e procesit zgjedhor. Ajo theksoi rëndësinë e përfaqësimit të grave në listat zgjedhore, buxhetimin gjinor, praninë e tyre në medie, si dhe trajtimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore gjatë fushatës, përfshirë dhunën në internet. Në këtë kontekst, presidentja Osmani gjithashtu ritheksoi kërkesën që ky mision të fokusohet edhe në respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, posaçërisht sa i përket qasjes së tyre në vendvotime.

Presidentja vlerësoi se barazia gjinore është një nga parimet themelore të demokracisë dhe duhet të reflektohet në të gjitha aspektet e procesit zgjedhor.

Më tej, presidentja Osmani, bazuar në raportet e mbarëvajtjes së zgjedhjeve të kaluara, përfshirë raportet e misioneve vëzhguese të BE-së, të cilat kanë konstatuar se në komunat veriore të Republikës së Kosovës ka pasur ndërhyrje të paligjshme, frikësim dhe pengim të realizimit të së drejtës për votim të lirë, shtroi nevojën që vëzhguesit e këtij Misioni të BE-së të sigurohen se e monitorojnë se a po realizohet e drejta e votës së lirë plotësisht, konform standardeve më të larta demokratike në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Edhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka pritur të enjten në takim Nathalie Loiseau, anëtare e Parlamentit Evropian dhe shefe e Misionit të Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EU EOM) në Kosovë.

Takimi u përqendrua në angazhimin e Kosovës për të siguruar zgjedhje të lira, të



ndershme dhe transparente, duke theksuar përpjekjet e vazhdueshme për forcimin e proceseve demokratike të vendit. Kryetari Krasniqi shprehu mirënjohjen e tij për Loiseau dhe EU EOM për rolin e tyre të rëndësishëm në mbështetjen e sistemit zgjedhor të Kosovës. Ai theksoi rëndësinë e misioneve të mëparshme të BE-së për mbështetjen e reformave zgjedhore, rritjen e transparencës dhe fuqizimin e besimit publik në procesin zgjedhor. "Kosova është krenare për traditën e saj të organizimit të zgjedhjeve demokratike, të lira dhe transparente", tha Krasniqi. "Respektimi i vazhdueshëm i rezultateve zgjedhore reflekton pjekurinë dhe vlerat tona demokratike". Gjatë diskutimit u theksua, gjithashtu, se Ligji i ri për Zgjedhjet e Përgjithshme përbën një çast historik në reformat zgjedhore të Kosovës. Kryetari

Krasniqi theksoi se monitorimi dhe rekomandimet e misionit do të jenë thelbësore për vlerësimin e ndikimit të këtij ligji, identifikimin e përparësive dhe adresimin e çdo mangësie të mundshme.

Kryetari Krasniqi siguroi Loiseau për bashkëpunim të plotë me EU EOM për të garantuar suksesin e misionit. Në takim u diskutuan tema si përfaqësimi i grave në proceset politike, lufta kundër gjuhës së urrejtjes dhe sfidat e shkaktuara nga lajmet e rreme.

Krasniqi rikonfirmoi përkushtimin e PDK-së për ta promovuar gjithëpërfshirjen dhe për ta luftuar dezinformimin, duke siguruar ambient zgjedhor të drejtë dhe të besueshëm. Loiseau vlerësoi përparimin e Kosovës dhe rikonfirmoi përkushtimin e BE-së për ta mbështetur rrugëtimin demokratik të vendit.

Takimi nënvizoi rëndësinë e

bashkëpunimit midis Kosovës dhe BE-së për forcimin e demokracisë dhe sigurimin e zgjedhjeve transparente që reflektojnë vullnetin e qytetarëve.

Edhe kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) priten në takim eurodeputeten Nathalie Loiseau, njëkohësisht shefe e Misionit Vëzhgues të Zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian.

Ky takim u fokusua në përgatitjet për organizimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2025. Kryesuesi Radoniqi theksoi rëndësinë e vëzhgimit të zgjedhjeve, duke siguruar që gjetjet e vëzhguesve do të merren seriozisht nga KQZ-ja.

Po ashtu, KQZ informoi Loiseau dhe ekipin e BE-së për përgatitjet në zhvillim, përfshirë votimin përmes postës për qytetarët jashtë Kosovës dhe trajnimin e trupave zgjedhore.

KOMF: Mos i shfrytëzoni fëmijët në fushatë zgjedhore!

PRISHTINË, 16 JANAR - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF ka bërë me dije se informacionet dhe raportimet nga terreni ditët e fundit kanë treguar se në disa raste partitë politike po i përdorin dhe përfshijnë fëmijë për t'i promovuar subjektet politike. Nisur nga kjo, KOMF u bënë thirrje të gjitha subjekteve politike që të mos i shfrytëzojnë fëmijët në kuadër të fushatës zgjedhore. "Përfshirja e fëmijëve në fushatë elektorale nga subjektet politike përbën shkelje të të drejtave të tyre, shfrytëzim, e në të njëjtën kohë nuk është në interesin më të mirë të tyre", ka njoftuar KOMF. Po ashtu, KOMF i bënë thirrje Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që t'i monitorojë aktivitetet e subjekteve politike

dhe në çdo rast të shkeljes së konstatuar të lidhur me shfrytëzimin e fëmijëve si pjesë e fushatës elektorale, të ndërmerren masa bazuar në legjislacionin në fuqi.

KOMF-i në të njëjtën kohë u bënë thirrje edhe prindërve të mos i politizojnë fëmijët, të mos i përfshijnë në asnjë formë në fushatë dhe të mos i marrin fëmijët me vete në aktivitetet të cilat organizohen nga partitë politike.

Gjithashtu, KOMF-i u bënë thirrje medieve të cilat mbulojnë fushatën zgjedhore, të ndërmerren rol aktiv për monitorimin e situatës dhe t'i bëjnë publike rastet ku fëmijët shfrytëzohen për qëllime partiake gjatë fushatës elektorale, gjithmonë duke mbrojtur identitetin dhe integritetin e fëmijës.



Zgjedhjet në Kosovë, sfidë e madhe si për qeverinë ashtu edhe për opozitën



Shkruan: Fadil MALOKU

1. Zgjedhjet e 9 shkurtit, midis shumë preokupimeve sociale e shqetësimeve evidente ekonomike e madje edhe ngjarjeve të imponuara politike, qytetarinë kosovare për herë të parë në procesin e shtet ndërtimit dhe inaugurimit të demokracisë, do i testojnë edhe dy tundime të reja sociopolitike. Ose thënë më ndryshe, elektorati i zgjedhjeve të 9 shkurtit do

“provokohet” për herë të parë me dy oferta serioze që në pesë palë zgjedhje të mëhershme ishin në disproporcion aktiv dhe asimetri interesante, për shoqëritë ë ende nuk i tejkaluan “ethet” e transicionit. Këto dy tundime apo ndryshe që mund të konsistohen e shquhen edhe si dy hamendësime aktive, apo edhe si dy situata joshjeje problematike në kuptimin që elektorati duhet ta zgjedh vetëm njërin nga këto, janë pasuri e pjekurisë qytetare.

2. Përzgjedhja, natyrisht do bëhet në bazë të kritereve e standardeve të dëshmuara demokratike; shkallës së emancipimit politik, lirisë personale, afinitetit dhe bindjes ideologjike, pastaj

pirjes dhe interesimit për ta “mirëmbajtur” edhe më tej frymën e politizimit të çdo procesi e zhvillimi që mbretëroj në shoqërinë kosovare gjatë gjithë periudhës së pasluftës. Themi frymë politizuese, edhe për shkakun se Kosova, si shteti më i vonshëm, identitetin e vetë shtetërorë, e ndërtoj dhe mbi ndërtoj përmes një procesi të dhimbshëm dhe një kostoje në njerëz e të mira materiale. Frymë kjo që siguroj rritjen e sigurisë, stabilitetit dhe kërcënimeve që vinin dhe ende vijjnë pareshtur nga Serbia (tentim agresioni bashkë me aktet terroriste) për pjesën veriore të vendit.

3. Tundimi apo hamendësimi i elektoratit që do votoj në

zgjedhjet e 9 shkurtit, thënë edhe më thjesht, duhet të përcaktohet ose në opsionin; a. (lexo; ofertën) që ka të bëjë me çështjet e standardit jetësorë, apo temat që kanë të bëjnë shumë me shumë me premtimet e rekrutuara nga sfera e interesave personale e familjare, e që kanë të bëjnë me (ngritjen e pagave, hapjen e vendeve të reja të punës, sigurimet shëndetësore, perspektivën në edukim, cilësinë në arsimim, etj. Pra, joshjet për një mirëqenie më të lartë, ku hetohet që se ca parti opozitare kanë shkuar shumë më larg me nuhatjen e nevojave qytetare. Nevoja këto që në këto kohëra krizash, mund ta luhat, intrigoj po edhe dislokoj disponimin apo prirjen për të

votuar për njërin apo tjetrin subjekt. Ose, në opsionin b. (lexo ofertën) që ka të bëjë me vazhdimin e politizimit të temave të interesit shtetëror? Mjerisht, nuk kemi ndonjë studim të pavarur sociologjik, i cili paraprakisht do e dëshmonte njërin apo tjetrin opsion...Kështu që satisfaksion i vetëm për ta kuptuar të vërtetën për hamendësimin dhe tundimin e parë të pasluftës, për elektoratin kosovar mbetën zgjedhjet e 9 shkurtit. Votuesit e emancipuar politikisht, para se me shku te kutitë e votimit duhet me gjakftohtësi të mendojnë dhe të votojnë, për subjektin që i përmbush kërkesat (politike) apo nevojat (ekonomike) e tyre...

IKD-ja: Qeveria ta rishikojë Draft-Strategjinë Kundër Korrupsionit

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 16 JANAR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar raportin analitik “Saga e Strategjisë Kundër Korrupsionit”, në të cilin analizohet Draft-Strategjia Kundër Korrupsionit e publikuar nga Zyra e Kryeministrit.

IKD-ja thekson faktin se Kosova nuk ka Strategi Kundër Korrupsionit që nga viti 2019 dhe se nuk është respektuar as edhe afati për përfundimin e Strategjisë, i cili ishte deri më 1 dhjetor 2023. Sipas gjetjeve të IKD-së, edhe përkundër vonesave të pakuptueshme dhe të panevojshme nga qeveria aktuale në miratimin e strategjisë, ndërmarrja e veprimeve drejt hartimit të Draft-Strategjisë Kundër Korrupsionit është një hap pozitiv drejt përmbushjes së këtij obligimi ligjor, me kushtin që të trajtohen me kujdes komentet dhe sugjerimet e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare gjatë procesit të konsultimit publik.

Gjetjet e IKD-së theksojnë se nuk ishte respektuar as Rregullorja e Punës së qeverisë në lidhje me afatin për komente, pasi ishte ofruar një afat prej vetëm nëntë ditësh punë për të dhënë komente në platformën e konsultimit, duke injoruar afatin minimal prej 15-ditësh. Sipas IKD-së, Draft-Strategjia dhe Draft-Plani i Veprimit nuk janë hartuar në përputhje me Manualin e Qeverisë për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjive dhe Planeve të tyre të Veprimit.

Për më tepër, IKD-ja gjen se ky dokument ka mangësi substanciale në identifikimin e

problemeve, nuk bën një pasqyrim real dhe praktik të problemeve në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, në mënyrë që lehtësisht të identifikoheshin edhe masat e nevojshme. Ndër të tjera, në raport theksohet edhe se Draft-Strategjia përfshin masa të cilat nuk përbëjnë qartësisht masa anti-korrupsion. Draft-strategjisë i mungojnë masa të rëndësishme në fusha kyçe kundër korrupsionit dhe se shumë prej fushave kryesiale që paraqesin potencial të lartë për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit nuk janë pjesë e Draft-Strategjisë.

IKD-ja thekson se Draft-Strategjia duhet të bëjë një pasqyrim adekuat të gjendjes faktike dhe t'i përmbajë edhe problemet praktike të ngritura nga publiku në vitet e fundit. Sipas IKD-së, procedurat e mbyllura të prokurimit publik kanë ngritur dyshime për transparencën dhe ligjshmërinë e shpenzimit të parasë publike. Po ashtu, thuhet se raportimet për hakmarrje ndaj sinjalizuesve tregojnë për dobësi të sistemit në mbrojtjen e këtyre personave që luajnë rol kyç në zbulimin e keqpërdorimeve.

Më tej, theksohet edhe se dyshimet për keqpërdorime në ministri të ndryshme, përdorimi i kontratave njëburimore nga qeveria dhe nivelet komunale, si dhe korrupsioni i pretenduar në ndërmarrjet publike, sjellin në pah nevojën për rritjen e mbikëqyrjes institucionale dhe pavarësisë nga ndikimet politike. Po ashtu, në këtë raport thuhet edhe se dyshimet për përfshirjen e zyrtarëve të lartë shtetërorë në veprime të kundërligjshme dhe dyshimet për probleme në ndarjen e subvencioneve



evidentojnë nevojën për trajtimin e këtyre fushave. Sipas IKD-së, këto problematika kërkojnë një qasje gjithëpërfshirëse në Draft-Strategji.

Në shumë raste, Draft-Strategjia përmban vetëm përshkrim të burimeve të caktuara dhe jo një qasje dhe vlerësim analitik të të dhënave mbi bazën e këtyre burimeve. Përkundër se fokusi në digitalizim dhe transparencë konsiderohet si aspekt pozitiv, IKD thekson se kërkohet specifikim i veprimeve dhe vlerësimi i rreziqeve për këtë qëllim. “IKD ka identifikuar edhe pasaktësi në përmbajtjen e Draft-Strategjisë: Draft-Strategjia i është referuar Indeksit të Transparency International për vitin 2024, përderisa i njëjti nuk është publikuar ende si dhe i është referuar gabimisht Komisionit të Venecias si organ i Bashkimit Evropian, përderisa i njëjti është organ i Këshillit të Evropës.

IKD-ja i ka rekomanduar Qeverisë që Draft-Strategjia ta

shqyrtojë parandalimin dhe luftimin e korrupsionit përmes dimensionit gjinor. Sipas IKD-së, qasja gjinore në raport me parandalimin dhe luftimin e korrupsionit do ta theksonte rëndësinë e përfshirjes së grave në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit”, thuhet në njoftim. Në anën tjetër, IKD-ja vlerëson se në Draft-Strategji duhet të trajtohen edhe disa masa të rëndësishme në fushën e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, e që disa prej tyre përmendën vetëm në kontekst të përgjithshëm apo në kuadër të masave të tjera, por nuk adresohen në mënyrë adekuate.

Kështu, sipas IKD-së, disa prej masave që duhet të përfshijë Draft Strategjia kanë të bëjnë me parandalimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesit; mbrojtjen e sinjalizuesve; vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit në fusha apo sektorë të ndryshëm dhe vlerësimin e rreziqeve dhe zbrazëtirave të legjislacionit (primar dhe sekondar) që

potencialisht mund ta rrisin korrupsionin.

Po ashtu, masat që duhet të përfshijë Draft-Strategjia, sipas IKD-së, janë vlerësimi nëse legjislacioni është në pajtim me standardet ndërkombëtare kundër korrupsionit, harmonizimi i legjislacionit me direktivat e BE-së, ndihma juridike ndërkombëtare, anëtarësimi në mekanizmat ndërkombëtarë, Policia e Kosovës, konfiskimi i pasurisë së kundërligjshme, planet e integritetit, niveli sekondar i qeverisjes, diskutimet publike në rastet e vendimeve qeveritare me efekt të gjerë financiar etj.

Gjithashtu, IKD-ja gjen se propozimi për zgjerimin e kompetencave të Gjykatës Kushtetuese, për ta bërë atë institucion mbikëqyrës të KGJK-së dhe KPK-së, bie ndesh me Kushtetutën dhe rolin e drejtësisë kushtetuese në Kosovë. Kjo pasi, sipas këtij raporti, këto masa mund ta kufizojnë pavarësinë e institucioneve të drejtësisë dhe krijojnë një disbalancë në ndarjen e pushteteve.

Limaj: Me fitoren tonë shëndetësia në të gjitha nivelet do të preket dhe trajtohet nga dora e shtetit

MALISHEVË, 16 JANAR - Lideri i Nismës Socialdemokrate dhe kandidat për deputet me numër 2 në listën e koalicionit AAK-Nisma, Fatmir Limaj, ka takuar punëtorët shëndetësorë të shtëpisë së shëndetit "Shpëtim Robaj" në Malishevë. "Për Kosovën

fituese duhen veç vepra, e njëra nga veprat e Nismës është edhe shtëpia e shëndetit 'Shpëtim Robaj'. Në Malishevë, për një bashkëbisedim të mirëfilltë me personelin e kësaj qendre, e cila, me infrastrukturën e përmirësuar nga qeverisja komunale, dhe për ofrimin e

shërbimeve ndaj qytetarëve, tashmë është bërë shembull për gjithë Kosovën", ka thënë Limaj. Ai ka theksuar se me fitoren e tyre në zgjedhjet e 9 shkurtit, dhe me kuadrot profesionale, shëndetësia në të gjitha nivelet e saj do të preket dhe trajtohet nga dora e shtetit.



Hamza e sjell në Kosovë themeluesin e PISA-s: Mezi pres që qeveria ime të punojë ngushtë me ju

PRISHTINË, 16 JANAR - Kandidati për kryeministër i PDK-së, Bedri Hamza, ka marrë përkrahje nga një prej ekspertëve më të njohur në botë për arsimin, Andreas Schleicher, i cili është themelues dhe zhvillues i sistemit të testeve dhe instrumenteve arsimore të PISA-s. "Për mua është kënaqësi që këtë mëngjes ta pres mikun tim, Andreas, për vizitë këtu në Prishtinë. Andreas është themelues dhe udhëheqës i PISA-s. Është një prej ekspertëve më të njohur që e kam takuar. Jam shumë mirënjohës dhe shumë falënderues. Për mua, prioritet është arsimit. E di që çdo para e

shpenzuar në arsim është investimi më i mirë për shoqërinë. Ne kemi nevojë që ta reformojmë arsimin dhe jam i bindur që ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ne do ta kemi përkrahjen e Andreas, miqve të tij dhe shokëve të tij, që ta përmirësojmë sistemin arsimor në Kosovë. Unë e di që arsimit në Kosovë mundet më mirë", ka thënë Hamza. Në anën tjetër, Andreas Schleicher, i cili njëherësh është drejtor i përgjithshëm në OECD për Arsimin, ka thënë se mezi pret të punojë së bashku dhe ta ndihmojë Kosovën që të bëhet një nga sistemet arsimore më të avancuara në botë. "Ne mezi

presim të punojmë së bashku dhe ta ndihmojmë Kosovën të bëhet një nga sistemet arsimore më të avancuara në botë. Unë besoj se kjo është e ardhmja juaj si shtet dhe shkollat tuaja sot do të jenë e ardhmja e ekonomisë dhe shoqërisë suaj. Pikërisht për këtë arsye, ky është një investim kaq i rëndësishëm, dhe unë e admiroj përkushtimin tuaj për këtë qëllim", ka thënë Andreas Schleicher, themeluesi i PISA-s. Testi i PISA-s është më i rëndësishmi në botë për matjen e performancës dhe Hamza ka siguruar se nxënësit tanë nuk do të radhiten kurrë më në fund të listave për performancën më të ulët.



Nënshkruhet marrëveshja në vlerë 3.3 milionë euro për ndërtimin e shkollës së re të mjekësisë në Gjilan



GJILAN, 16 JANAR - Është arritur marrëveshja e bashkëpunimit për ndërtimin e Shkollës së Mjekësisë "Dr. Asllan Elezi" në Gjilan, në mes të komunës së Gjilanit me Islamic Relief Kosova. Nënshkrimi i marrëveshjes u

bë nga kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni dhe drejtori i Islamic Relief Kosova, Mohamed Soliman. Me ndërtimin e shkollës së re, nxënësit do të kenë një objekt të pajisur me të gjitha pajisjet dhe kushtet e nevojshme.

Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, tha se do të investohen 3.3 milionë euro për shkollën e re të mjekësisë në Gjilan. "Sot, së bashku me përfaqësuesit e organizatës Islamic Relief Kosova, nënshkruam memorandumun e bashkëpunimit për

ndërtimin e Shkollës së Mjekësisë 'Dr. Asllan Elezi' në Gjilan. Jam i lumtur që nxënësit do të kenë një objekt të ri dhe modern, i pajisur me të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin e mësimin", tha kryetari Alban Hyseni.

Kadetët e FSK-së trajnohen për mbijetesë në kushte dimërore



PRISHTINË, 16 JANAR - Në Qendrën Ndërkombëtare Trajnuese për Kërkim Shpëtim (QNTKSh) është realizuar trajnimi për Mbijetesë Malore në kushte dimërore për kadetët e vitit të 4-t të Qendrës për Studime Universitare të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ky program intensiv është krijuar për t'i sfiduar kadetët

dhe për t'i pajisur ata me aftësi thelbësore të mbijetesës në kushte ekstreme malore duke u fokusuar në mësimin e teknikave të ngjitjes dhe zbritjes me litar, ndërtimin e strehëve dhe ndezjen e zjarreve në kushte të vështira, orientimin dhe navigimin në terrene të ashpra dhe menaxhimin e burimeve

materiale nga natyra. Kadetët treguan shkathtësitë e tyre për t'u përballur me sfidat ku kjo tregon se këta të rinj do të jenë udhëheqës të ardhshëm të njëjve të FSK-së, duke punuar dhe vepruar me punë në ekip dhe vendosmëri, duke mishëruar vlerat thelbësore të shërbimit dhe gatishmërisë.

Kurti viziton 'TrePharm', thotë se është një nga prodhuesit më të mëdhenj të barnave

PRISHTINË, 16 JANAR - Kryeministri Albin Kurti në "Facebook" ka thënë se me 10 departamente e 105 punonjës, nga të cilët 71 gra e që mbulojnë pjesën më të madhe edhe të strukturës organizative,

"TrePharm" është një nga prodhuesit më të mëdhenj të barnave me bazë në Kosovë dhe rajon. Gjatë vizitës në "TrePharm", Kurti ka thënë se "kompani vendore që rriten e kontribuojnë edhe

për shtetin na duhen sa më shumë, që të mund të vazhdojmë ta rrisim punësimin e meritokracinë dhe ta rrisim barazinë shoqërore e mirëqenien për të gjithë".



Me pagë nën minimale, punëtorët e sigurimit dhe të mirëmbajtjes shkelen në institucione

Përderisa palët e përfshira - Qeveria e Kosovës, komunat dhe kompanitë e kontraktuara - gjuajnë përgjegjësinë te njëra-tjetra, punëtorët e pastrimit dhe sigurimit në shumë institucione shtetërore vazhdojnë të paguhen jashtëligjshëm nën pagën minimale

PRISHTINË, 16 JANAR - Që nga 15 korriku i vitit 2008 Hakif Sylejmani ka kaluar nga të paktën tetë orë në ditë, e shpeshherë edhe më gjatë, duke ruajtur në objektet e ndryshme të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Në muajin e parë ai ishte punësuar punëtor i sigurimit fizik nga QKUK-ja, ndërsa më vonë për këtë shërbim u punësua përmes kompanie private. Për Sylejmanin, baba i katër fëmijëve, muaji i parë ka qenë më i miri financiarisht. "Në 2008-n e kam marrë rrogën 121 euro. I kam marrë 40 euro për rrugë, 40 euro për shujta ditore. Edhe çka kam marrë për kujdestari... rroga më dilte më e madhe në 2008-n sesa sot. Atëherë e merrja mbi 300 euro", thotë Sylejmani për Radion Evropa e Lirë. Aktualisht, i kontraktuar nga kompania "Security Code", Sylejmani paguhet nga 277 euro në muaj. Për rritjen e katër fëmijëve të tij - nga 6 deri në 14 vjeç - ai thotë se kjo pagë, që është nën pagën minimale, është e pamjaftueshme. "Me një pagë të tillë, një punëtor nuk është në gjendje t'i mbajë katër fëmijë. Po flas vetëm për t'i dërguar në shkollë, jo për t'u blerë libra, fletore dhe veshmbathje. Kjo është katastrofë", shton Sylejmani. I zgjedhur nga punëtorët e tjerë të sigurimit fizik në QKUK si përfaqësues i tyre, ai tregon se të gjithë punëtorët shpresojnë që këtë muaj të rregullohet çështja e pagës së tyre. Kompania e tij nuk iu përgjigj kërkesës së REL-it për komente. Por, në të njëjtën situatë me Sylejmanin gjenden edhe punëtorët e sigurimit fizik dhe ata të mirëmbajtjes në shumë institucione publike, pasi marrin pagë nën pagën e re minimale në Kosovë. Vlera e saj, e vendosur më 28 gusht të vitit të kaluar, është 350 euro. Të gjithë këta punëtorë janë punësuar nga kompani të kontraktuara nga institucione

shtetërore për kryerjen e këtyre shërbimeve. Në tenderët e hapur kompanitë tentojnë të aplikojnë me çmim sa më të ulët në mënyrë që të përzgjidhen për ta kryer shërbimin. "Kompanitë nuk kanë mundësi t'i rrisin pagat tani, sepse ato i kanë bërë kalkulimet që kanë në kontratë për kaq mjete", thotë Jusuf Azemi, drejtues i Federatës Sindikale të Punëtorëve Teknikë të Sektorit Privat të Kosovës, për Radion Evropa e Lirë. E dikur pasi kompanitë nënshkruan kontratat me institucionet shtetërore, Qeveria e Kosovës doli me vendimin për ta rritur ndjeshëm pagën minimale. Vendimi bëri që paga minimale të rritej në 350 euro nga 130 euro sa ishte për punëtorët nën 35 vjeç dhe 170 euro për punëtorët deri në 65 vjeç. "Është thënë se ka pasur rritje të pagës në 264 euro në vitin 2022, por ai ka qenë propozim i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) dhe në asnjë rrethanë vendim", sqaron Naim Jakaj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), për REL-in. Por, edhe tani që rritja e pagës është konkretizuar nga propozimi në vendim, ai sërish nuk zbatohet plotësisht. Radio Evropa e Lirë ka kontaktuar disa nga kompanitë që ende i paguajnë punëtorët nën 350 euro, por vetëm kompania "Double I&I", e kontraktuar për pastrim në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Malishevë, ka qenë e gatshme për t'u prononcuar. Ajo sqaron se ka bërë kërkesë në komunën e Malishevës për t'ia rritur vlerën e kontratës - që vlen edhe për një vit e gjysmë - pas rritjes së pagës minimale, por se një gjë e tillë nuk ka ndodhur. Menaxheri i kësaj kompanie, Ardian Aliu, thotë se institucione të tjera ku kjo kompani ofron shërbime, si Korporata Energjetike e Kosovës, kanë marrë parasysh kërkesën dhe e kanë rritur



vlerën e kontratës. "Për çdo muaj kemi dërguar email duke kërkuar rritje të vlerës së kontratës. Ne nuk jemi për t'i shkëlur të drejtat e punëtorëve. Me punëtorët kemi arritur marrëveshje që, përderisa nuk na përgjigjen nga komuna, ne nuk kemi mjete që t'i mbulojmë këto shpenzime", thotë Aliu për REL-in. Edhe për përfaqësuesit sindikalë të punëtorëve faji nuk qëndron te pronarët e kompanive, por te Qeveria e Kosovës. Një gjë e tillë theksohet edhe në denoncimin e bërë nga Federata Sindikale e Punëtorëve Teknikë të Sektorit Privat të Kosovës në Inspektorat të Punës dhe Administratë Tatimore të Kosovës (ATK). "Këto janë kompani që kryejnë shërbime për institucionet shtetërore dhe me këtë rast faji nuk është te kompanitë, por tek institucionet për të cilat këto kompani kryejnë shërbime", thuhet në denoncimin e bërë. Inspektorati i Punës nuk është përgjigjur në pyetjet e REL-it, ndërsa ATK-ja ka vlerësuar se kjo çështje i takon Inspektoratit të Punës. Kryesuesi i Sindikatës, Azemi, beson se qeveria duhet t'i subvencionojë kompanitë e kontraktuara, në mënyrë që ato të kenë mundësi financiare t'i paguajnë punëtorët e tyre sipas vendimit për pagën minimale. Ai beson se MFPT-ja është dashur ta dijë se një problem i tillë do të shfaqej dhe fakti që nuk ka ndërmarrë ndonjë masë për t'i subvencionuar kompanitë e kontraktuara nga institucionet shtetërore, "është qesharak". "Është obligim i Qeverisë së Kosovës, nuk është obligim i

kompanive", thotë Azemi. Por, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) nuk pajtohet. Në një përgjigje për REL-in, nga kjo ministri thonë se, fillimisht, asnjë kompani nuk ka kërkuar subvencionim të tillë dhe se ajo "nuk është përgjegjëse për të pranuar kërkesa nga bizneset". "Presim që kompanitë ta zbatojnë këtë ndryshim dhe të mos paguajnë nën këtë prag. Ky obligim është i qartë dhe i detyrueshëm për të gjithë punëdhënësit", thuhet në përgjigjen e MFPT-së. Vendimi për rritjen e pagës minimale ka hyrë në fuqi më 1 tetor. Sindikata e Punëtorëve Teknikë kërkon që humbja e punëtorëve në pagë gjatë muajve tetor, nëntor, dhjetor dhe muajve të ardhshëm, derisa të gjendet një zgjidhje, t'u kompensohet atyre në mënyrë retroaktive. Përndryshe, Azemi paralajmëron se do të ngrënë padi ndaj vetë Qeverisë së Kosovës. "Nuk mund të jetë i përkryer asnjë ligj, por te ne kryesore është që atë ligj që e kemi në fuqi, ta respektojnë ata që e kanë nxjerrë. Qeveria e Kosovës po i shkel vetë vendimet që i ka nxjerrë", thotë Azemi. Jakaj nga IKD-ja sqaron se i gjithë procesi lidhur me pagën minimale, është përcjellë me parregullsi. Procedura ligjore parashihet që fillimisht Qeveria, në fund të çdo viti kalendarik, të propozojë pagë minimale në bazë të një propozimi nga Këshilli Ekonomik dhe Social (KES). Por, KES-i - që përbëhet nga pesë përfaqësues të punëtorëve (sindikatave), pesë përfaqësues të punëdhënëseve (odat

ekonomike) dhe pesë zyrtarë që caktohen nga Qeveria - nuk është funksional që nga viti 2023. Më 18 prill të atij viti, anëtarëve u ka skaduar mandati katërvjeçar dhe MFPT-ja ende nuk është angazhuar për rifunksionalizimin e tij. "Në mungesë të konsultimeve me sindikatat, me odat ekonomike dhe me publikun, e po ashtu dhe në mungesë të përgatitjeve të nevojshme të tjera, tanimë janë shfaqur situata problematike, ku shumë nga kompanitë kanë nënshkruar kontrata me institucionet publike, bazuar në pagën minimale të mëparshme prej 170 eurosh", thotë Jakaj për REL-in. "Me rritjen e pagës minimale, këto kontrata janë bërë të vështira për t'u zbatuar, pasi kostot operative janë rritur në mënyrë të ndjeshme", shton ai. Jakaj propozon që vlera e kontratave të përditësohet tani, në mënyrë që të mos dëmtohen financiarisht as kompanitë, e as punëtorët. "Qeveria duhet të ndërmarrë hapa për t'i rishikuar kontratat ekzistuese midis kompanive private dhe institucioneve publike, duke përfshirë klauzola që reflektojnë rritjen e pagës minimale, duke qenë se kjo kërkesë është në pajtim me Ligjin për prokurimin publik", thotë ai. Për Sylejmanin, i punësuar si rojë fizike në QKUK, pak rëndësi ka se kush e ka fajin. Ai vetëm shpreson që atij dhe kolegëve të tij do t'u respektohen të drejtat. "Ne po kërkojmë atë që na takon. Për atë që s'na takon, s'po i kërkojmë askujt të na e japë", thotë ai.

Qeveria miraton programin për reforma në ekonomi 2025-2027

Prishtinë, 16 janar - Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhje elektronike, në të cilën ka miratuar programin për reforma në ekonomi 2025-

2027 dhe vendimin për autorizimin e ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, që t'i aprovojë transferimet nga

nënprogrami "Shpenzimet e paparashikuara" në ndonjë nënprogram tjetër në tabelën 3.1 dhe 4.1 të Ligjit nr. 08/L-332 mbi Ndarjet Buxhetore për

Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, për shumatat individuale të kërkuara deri në vlerën prej 40 mijë eurosh.



Letër një fëmije të porsalindur

Të dashur fëmijë të ardhur në botë në vitin 2025, tashmë keni një emërtim: jeni Gjenerata Beta. Por përpiquni të rebeloheni kundër manisë sonë për të kataloguar madje edhe të ardhmen



Të dashur fëmijë të Gjeneratës Beta, nuk keni filluar ende të jetoni dhe tashmë ju kanë emërtuar. Ose më mirë, ju kanë "markuar". Ju quajnë "bijtë e së ardhmes", sepse rrota juaj e kohës sapo ka filluar të rrotullohet. Por në fakt, e ardhmja që po ju ndërtohet është vetëm një projektion i të tashmes në të cilën sapo po filloni të hidhni hapat e parë.

Gjeneratat që ju paraprinë, nga baby boomers tek millennials, deri tek Gen Z (të lindurit midis viteve 1997 dhe 2012), titullin e tyre e fituan më vonë, bazuar në atë që përjetuan dhe si e përjetuan. Ndërsa ju, jeni të lindur tashmë të klasifikuar. Keni një histori ku jeni vetëm aktorë të dorës së dytë, por që rrezikon t'ju rëndojë si një fat i paracaktuar. Që në të vërtetë i ngjan më shumë një profilizimi – një identifikim i

një tipi konsumatori.

Në këtë kuptim, fati juaj është i njëjtë me atë të Gjeneratës Alfa. Si ata, edhe ju identifikoheni kryesisht bazuar në aftësinë tuaj të ardhshme për të ndikuar në sjelljet ekonomike të prindërve tuaj dhe, më vonë, nga fuqia blerëse që pritet të arrini brenda disa viteve.

Me gjasë, dhe për fat të mirë, e gjithë kjo narrativë e tepërt rreth jush nuk do të përputhet me atë që do të bëni dhe do të jeni në të vërtetë. Në fakt, të gjitha këto "këshilla" dhe "mendime" që pedagogjizojnë dhe psikologjizojnë atë që bëjnë dhe mendojnë fëmijët janë më shumë një placebo për prindër gjithnjë e më të humbur, për shkak të distancës midis brezave që përjetojmë sot.

Gjithashtu, këto janë një treg gjithnjë e më fitimprurës për "guru-të" e këshillimit, të cilët

gjuajnë pasionet dhe obsesionet e të rinjve. Ata, të karikaturizuar nga etiketa reduktuese si screenagers (adoleshentë të ekranit), një "faunë" njerëzore e zhytur në teknologji, ose të varur nga rrjetet sociale, janë shpesh viktimat të demonizimit dhe frikës së pabazë, ashtu si dikur "mësuesit e këqij."

Mania për të parashikuar të ardhmen

Në fakt, kjo tendencë për të parashikuar kohën dhe për të hipotekuar të ardhmen është fëmijë e shoqërisë sonë të "momentit të fundit." Por në të vërtetë ka rrënjë shumë më të thella, që datojnë nga ai qytetërim i Dekalogut, nga i cili buron vizioni ynë për botën dhe jetën. Kjo është një kulturë e themeluar mbi klasifikimin e detajuar të

ngjarjeve dhe sjelljeve, në përpjekje për të mos i lënë asgjë rastësisë.

Në fillim ishte kaosi, pastaj erdhën ligjet, e më pas klasifikimet dhe krahasimet, që rendisin gjërat dhe njerëzit. Në thelb, nevoja jonë për klasifikime lind nga dëshira për t'i dhënë kuptim botës, për ta renditur atë dhe për ta shpjeguar.

Por e vërteta është se çdo klasifikim fsheh një mënyrë për të hedhur dritë në errësirën e botës, për të përzgjedhur atë që është më e rëndësishme. Me fjalë të tjera, është një përpjekje për të përballuar kompleksitetin e pafund të jetës duke e sintetizuar atë në një numër ose një etiketë.



Një përmbysje e historisë

Në qytetërimet e lashta,

njerëzit shikonin drejt së shkuarës për të kuptuar të tashmen. Në shoqëri moderne, ne pyesim vazhdimisht: "Si do të përfundojë?" Kjo e kthen historinë nga një studim i shkaqeve në një parashikim të pasojave. E ardhmja bëhet më e rëndësishme se e shkuara.

Për ju, të dashur fëmijë të Gjeneratës Beta, mesazhi më i mirë është ky: Mos lejoni që frikërat tona t'ju infektojnë. Mësoni t'i shihni të gjitha këto etiketime për atë që janë: përpjekje për të kontrolluar të papriturën e jetës. Ju, ndoshta më shumë se ne, mund të na mësoni si të ekuilibrojmë të ardhmen me të tashmen dhe si të përdorim teknologjinë me zgjuarsi dhe maturi.

Mirë se erdhët në botë! /
Marino NIOLA
La Repubblica – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Foda: Përparimi i vitit 2024, bazë e fortë për të ardhmen

PRISHTINË, 16 JANAR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës, Franco Foda, ka bërë një përmbledhje të hollësishme të vitit të parë në krye të "dardanëve", duke dhënë opinionin e tij mbi përparimin e skuadrës, afrimin e lojtarëve të rinj dhe pritshmëritë për sfidat e ardhshme. Në një intervistë për faqen zyrtare të FFK-së, Foda shpreh kënaqësinë për arritjet e ekipit gjatë vitit 2024 dhe optimizmin për ndeshjen kundër Islandës në mars 2025, që mund ta ngrrejë Kosovën në Ligën B të UEFA Nations League. Po ashtu, Foda ka ndarë përshtypjet e tij edhe mbi kampin stërvitor të organizuar për talentet premtuese të së ardhmes dhe rëndësinë e mbështetjes së tyre për zhvillimin e ekipit kombëtar.

Trajner, ky ka qenë viti juaj i parë që keni përfaqësuesen e Kosovës. Si mund ta përshkruani këtë vit nga perspektiva juaj?

Foda: Në përgjithësi mund të jemi shumë të kënaqur me vitin 2024. Ekipi është zhvilluar jashtëzakonisht mirë gjatë dhjetë muajve të fundit. Tani



kemi një dinamikë të shkëlqyer, konkurrencë të fortë brenda grupit dhe, mbi të gjitha, një frymë të madhe ekipi. Tani thjesht duhet të vazhdojmë këtë përparim në vitin 2025. Jam shumë i sigurt se në ndeshjet e ardhshme kundër Islandës do të performojmë mirë edhe atje.

Gjatë 2024-s ekipit të Kosovës i janë bashkuar shumë futbollistë. Sa kanë arritur të inkorporohen në ekip këta lojtarë dhe si e vlerësoni afrimin e tyre?

Foda: Çdo trajner është i lumtur kur ka lojtarë të rinj që sjellin energji të freskët në ekip.

Siç e përmenda më parë, tani kemi konkurrencë të fortë brenda skuadrës, gjë që është shumë e dobishme për ekipin. Besoj fort se këta lojtarë i kanë dhënë ekipit një impuls të ri, siç u tregua qartë në ndeshjet e fundit.

Marsi do të na sjellë ballafaqimin kundër Islandës, i vlefshëm për "play-off", ku mund të ngjitemi në Ligën B, si e vlerësoni kundërshtarin dhe ekipin tonë?

Foda: Megjithatë, mendoj se jemi pak të zhgënjyer që përfunduam vetëm të dytët në grupin tonë, veçanërisht pasi ndeshja e fundit në Rumani

tregoi se ishte e mundur më shumë në këtë grup. Islanda ka një ekip shumë dinamik dhe atletik. Shumë prej lojtarëve të tyre luajnë në liga të forta jashtë vendit. Megjithatë, nëse mund të ndërtojmë mbi performancat e vitit 2024, veçanërisht nëse luajmë si në ndeshjen e fundit jashtë fushës në Rumani, atëherë kemi shanse shumë të mira të përballemi me Islandën dhe, mbi të gjitha, të ngjitemi në Ligën B.

Gjatë katër ditëve të kaluara, FFK ka organizuar një kamp me talentet dhe lojtarët premtues të së ardhmes, të cilët janë potencial për Kombëtaren A të Kosovës. Si shkoj kampi dhe a jeni i kënaqur me atë që futbollistët treguan në këtë kamp?

Foda: Për ekipin tim të trajnerëve dhe për mua ishte e rëndësishme t'i njihnim personalisht lojtarët më të mirë ose talentet e reja më premtuese që mund të jenë të përshtatshëm për ekipin kombëtar të Kosovës në të ardhmen. Donim të shikonim më nga afër aftësitë e tyre atletike këtu në terren. Gjithashtu, donim të kishim

biseda me ta. Dhe besoj se seancat stërvitore gjatë ditëve të fundit ishin shumë, shumë të mira. Kishim intensitet të mirë në stërvitje. Lojtarët janë të gjithë shumë të etur për të mësuar, shumë kuriozë, por gjëja më e rëndësishme për ne ishte t'ua përcillnim idetë, parimet dhe rregullat tona lojtarëve brenda ekipit kombëtar. Dhe e kemi bërë këtë gjatë ditëve të fundit. Jemi shumë, shumë të kënaqur me këtë kamp stërvitor. Mendoj se do të jetë shumë e rëndësishme për të ardhmen të vazhdojmë të mbajmë kampe të tilla stërvitore, sepse këta janë lojtarët tanë të së ardhmes, talentet tona për të ardhmen. Duhet t'i kultivojmë dhe t'i zhvillojmë më tej. Siç e përmenda tashmë, do të jetë thelbësore për ne t'i mbështesim këta lojtarë të rinj në të ardhmen. Shumë prej tyre tashmë luajnë jashtë vendit, ndërsa të tjerë luajnë këtu në ligën vendase. Duhet t'i shoqërojmë, t'i promovojmë, t'i zhvillojmë më tej dhe të përpiqemi t'i mbështesim në punën e tyre të përditshme, sepse këta lojtarë përfaqësojnë të ardhmen e Kosovës.

Vëllaznimi zëvendëson Leotrim Krasniqin me Mirel Josën

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 16 JANAR - Leotrim Krasniqi nuk është më trajner i Vëllaznimit, ndërsa trajneri i ri i klubit gjakovar do të jetë Mirel Josa. Vëllaznimi ka njoftuar përmes faqes zyrtare se i ka ndarë rrugët me trajnerin Krasniqi, derisa i kanë uruar suksese dhe e kanë falënderuar për bashkëpunimin. "Ju njoftojmë se kryesia e klubit ka vendosur që të ndërpres bashkëpunimin me kryetrajnerin Leotrim Krasniqi. Kryetrajnerin Krasniqi e falënderojmë për

bashkëpunimin korrekt dhe për kontributin që ka dhënë, si dhe i urojmë suksese të mëtutjeshme në karrierën e tij. Për informacione të tjera rreth shtabit teknik do të njoftoheni me kohë", thuhet në njoftimin e klubit kuqezi.

Vëllaznimi nuk ka humbur kohë dhe të enjten e ka paraqitur trajnerin e ri, Mirel Josa. Trajneri nga Shqipëria edhe në të kaluarën ka qenë pjesë e futbollit të Kosovës, pasi e ka drejtuar Prishtinën. Klubet e mëparshme të Josës janë edhe KF Tirana, FC Skënderbeu dhe KF Vllaznia. "Mirë se vjen Mirel Josa! Me



kënaqësi ju njoftojmë që KF Vëllaznimi ka arritur marrëveshje me Trajnerin e

mirënjohur Mirel Josa. Josa nga sot e ka filluar detyrën e shefit të shtabit teknik në klubin

Kuqezi dhe përgatitjet për sezonin pranveror. Mirel Josa një emër i njohur në futbollin mbarëshqiptar, me një përvojë të jashtëzakonshme dhe një vizion të qartë për të vazhduar me KF Vëllaznimit", thuhet në njoftimin e Vëllaznimit.

Mirel Josa është shpallur kampion i Shqipërisë, dy herë fitues i Kupës së Shqipërisë, dy herë fitues i Superkupës së Shqipërisë, një herë fitues i Kupës së Kosovës. KF Vëllaznimi e mbylli pjesën e parë të sezonit në vendin e dytë në Grupin A të Ligës së Parë me 27 pikë, katër më pak se liderja, Drenica.

Gazetari turk paralajmëron largimin e Rashicës nga Beshiktashi

Stamboll, 16 janar - Milot Rashica është duke e kaluar sezonin e dytë në fanellën e Beshiktashit. Gazetari turk Serdar Saridah thotë se s'do të befasohej nëse ish-futbollisti i Werder Bremenit e Norwich Cityt do të largohej nga

Beshiktashi në këtë muaj pasi, sipas tij, kontributi i vushtriasit te bardhezinjtë nuk është mjaftueshëm i kënaqshëm. "Takimi i drejtuesve të klubit është mbajtur dje dhe aty është vendosur për lojtarët që nuk do të shiten. Të tjerët mund të

shiten nëse vijnë oferta. Chamberlain e Onana janë prioritete, ndërsa Immobile është, po ashtu, në listë, por pa humbur para. Musrati, Masuaku, por edhe Rashica. Shikoni, mos u befasoni nëse largohet Rashica. Rashica po

luan atje, por krahu i djathtë i sulmit nuk po shihet gjëkund. Nuk do të surprizohesha nëse Rashica shkon dhe Adama Traore vjen", ka deklaruar gazetari turk. 28-vjeçari ka kontratë me Beshiktashin deri në vitin 2027.




Konfirmohet lëndimi i rëndë i Brojës, shqiptari mund të kthehet te Chelsea

LIVERPOOL, 16 JANAR - Trajneri i Evertonit, David Moyes, ka konfirmuar lëndimin e rëndë të sulmuesit shqiptar Armando Broja, të cilit mund t'i ndërpritet huazimi dhe të rikthehet te klubi i tij Chelsea. Sulmuesi shqiptar ishte i pafat javën e kaluar në ndeshjen e raundit të

tretë të Kupës FA në mes të Evertonit dhe Peterboroughit. Broja u inkuadrui në lojë në minutën e 68, por menjëherë në minutën e 83-të pësoi një lëndim të rëndë, i cili e detyroi të largohet nga fusha me barelë. Disa ditë pas kësaj

ndeshjeje, trajneri i Evertonit, Moyes, ka treguar lëndimin e Brojës, duke thënë se mund të mungojë deri në tre muaj. Përveç kësaj, Evertoni mund t'ia ndërpresë huazimin dhe sulmuesi shqiptar të kthehet te Chelsea për rehabilitimin e tij nga

lëndimi. "Ne mendojmë se ai do të jetë jashtë për diku 10-12 javë. Janë ligamentet e kyçit të këmbës", ka thënë fillimisht Moyes. "Kjo ndoshta do të thotë se ka një mundësi që ai do të duhet të kthehet në Chelsea", ka përfunduar trajneri i Evertonit.



Ish-kapiteni i Interit: Icardi kontrollohej psikologjikisht nga Wanda, bënte çfarë donte ajo

MILANO, 16 JANAR - Andrea Ranocchia, ish-kapiteni i Interit, ka shprehur kritika të ashpra për rolin e Wanda Naras në performancat e Mauro Icardit ku sulmuesi argjentinas ishte pjesë e zikaltërve. Ish-futbollisti italian 36-vjeçar, i cili ka luajtur për Interin nga viti 2011 deri në 2022 dhe ka qenë 21 herë pjesë e ekipit kombëtar italian, tregoi se "dhoma e zhveshjes e një skuadre të Serisë A nuk është si një grup shokësh në bar. Interat dhe presionet janë të mëdha. Pas stërvitjes, në orën dy të pasdites, të gjithë shkojnë në shtëpi dhe deri të nesërmen nuk di asgjë për shokët e skuadrës, çfarë bëjnë ose çfarë nuk bëjnë".



Ranocchia kritikoi ashpër qëndrimin e Wanda Naras, e cila në atë kohë ishte gruaja dhe përfaqësuesja e shokut të tij të skuadrës, Mauro Icardi. Ai e akuzoi atë se zbulonte informacione të brendshme nga dhoma e zhveshjes së Interit: "Gjithçka ndodhi vërtet me

shoqëror; fliste me disa shokë skuadre në mënyrë të veçantë, por pastaj mbaronte aty". Ish-futbollisti, gjithashtu, mbrojti Interin nga zbulimet në media të Wanda Narës: "Klubi nuk bën kontrata me një grua që del në televizion... Çfarë mund të bënte Interi? Ishte gruaja ajo që dilte në televizion, jo Icardi. Wanda merrte pjesë në Tiki Taka dhe nxirrte gjëra nga dhoma e zhveshjes. Kujt i bënte mirë kjo? Mauros sigurisht që jo. Jashtë fushe kishte një grua që nuk e ndihmonte dhe krijonte gjithë këtë zhurmë mediatike". Lidhur me marrëdhënien mes Wanda Narës dhe Mauro Icardit, italianin ndau mendimin e tij: "Asnjëherë nuk kam dalë me Mauron jashtë fushës, as me të dhe Wandan si çift. Ndjesia ime, të cilën po e shohim edhe tani, është që ndoshta ajo e kontrollonte thuasje plotësisht në aspektin psikologjik. Në kuptimin që ai bënte gjithçka që ajo donte, por kjo është thjesht ndjesia ime".

Lakersat, Bucksit e Golden State rikthehen te fitorja, zhgënjejnë kampionët e Bostonit dhe Denverit

LOS ANXHELOS, 16 JANAR - Tjetër humbje për kampionët e Bostonit, që u ndalën nga Toronto (110-97). Një ndeshje me luhatje për Celtisin, ku



mungoi lojtari lider, ndërsa për kanadezët të gjithë titullarët realizuan mbi 10 pikë. Humbet edhe skuadra e Denverit, që në fushën e saj u mund me shifrat 128-108 nga Houstoni. Jalen Green me 34 pikë ishte më i miri për miqtë. Pa probleme fitoi

ekipi i Milwaukee, që falë 30 pikëve të Lillardit dhe 26 të Antetokounmpos, mundi me rezultat 122-93 Orlandon. Te fitorja rikthehet ekipi i lakersve, që mundi me shifrat 117-108 Miamin. 34 pikët e Herro për miqtë mbetën për statistikë, ndërsa për kalifornianët tre lojtarë realizuan mbi 20 pikë (Hachimura 23, Davis e LeBron nga 22 pikë secili). Fitoi edhe ekipi tjetër i Los Anxhelosit, ai i clippersave, që mundi thellë me rezultat 126-67 Brooklynin (Leonard 23 pikë). Ndërsa skuadra e Golden States, falë 31 pikëve të Stephen Curryt, mundi në sekondën e fundit 116-115 Minnesotan.

REZULTATET

Philadelphia - New York	119-125
Toronto - Boston	110-97
Chicago - Atlanta	94-110
Milwaukee - Orlando	122-93
New Orleans - Dallas	119-116
San Antonio - Memphis	115-129
Denver - Houston	108-128
Utah Jazz - Charlotte	112-117
Minnesota - Golden State	115-116
Lakers - Miami	117-108
Clippers - Brooklyn	126-67

Inzaghi: Kemi vështirësi dhe po mendojmë për transferime

Barazimi 2-2 ndaj Bolognas nuk është prituri mirë nga trajneri i Interit, Simone Inzaghi. Tashmë zikaltrit janë tri pikë pas Napolit në renditje. Trajneri i Interit foli

për merkaton e janarit dhe për përforcimet e mundshme që mund të vijnë në Milano: "Ne gjithmonë flasim për këtë me klubin dhe aty janë gjithmonë

të vëmendshëm". "Për momentin kemi vështirësi, fillimisht në mbrojtje dhe tani në mesfushë. Frattesi, gjithashtu, nuk mundi të luajë

nga fillimi. Fatkeqësisht munda të ndërroj dy lojtarë paksa të lodhur", u shpreh Inzaghi. Më tej, trajneri i Interit ka shtuar: "Ne po përpiqemi t'i

përsheptomë rikuperimet e lojtarëve të dëmtuar por, ndoshta, duhet ndonjë emër i ri që të na ndihmojë në çaste të vështira".

SHKURT

Villeneuve: Verstappeni mund të përfitojë nëse te McLarenit dhe Ferrari do të ketë rivalitet brenda skuadrës

Jacques Villeneuve, një nga ikonat e Formulës 1 dhe kampion bote, beson se Max Verstappeni mund të shpallet kampion edhe sezonin e ardhshëm edhe pse Red Bull tregoi se nuk është makina më e mirë në gjysmën e dytë të sezonit të vitit të kaluar. Ish-piloti kanadez shprehet se rivaliteti që do të kenë mes tyre pilotët e McLarenit dhe Ferrari mund ta ndihmojë Verstappenit. "Te McLarenit kemi Lando Norris dhe Oscar Piastrin që janë të fortë, janë pilotë fitues dhe që duajnë mes tyre për fitore", u shpreh Villeneuve. "E njëjta gjë është edhe te Ferrari, ku Charles Leclerc do të përballlet edhe me Lewis Hamiltonin brenda skuadrës për fitore. Kjo gjë u pa edhe vitin e kaluar me këta pilotë, ndërkohë që në mes është edhe Mercedesi, që mund të fitojë me George Russellin", ka shtuar kanadezi. "Ndërsa te Red Bull është vetëm Verstappeni që do të duelojë për fitore dhe kjo mund ta ndihmojë atë për t'u shpallur kampion bote. Red Bull do të fokusohet shumë te Maxi, ndërsa i riu Lawson do ta ndihmojë dhe ky do të jetë avantazh për Verstappenin", ka deklaruar Villeneuve.

Klubi saudit ofron 77 milionë euro për Salahun

Në Angli janë të bindur se Mohamed Salah do të transferohet në Arabinë Saudite gjatë verës. Për 32-vjeçarin mësohet se Turki Alalshikh i ka gjetur vend në ekipin e Al-Hilalit. Këshilltari i Arabisë Saudite në Oborin Mbretëror me gradën e Ministrit dhe kryetari aktual i Autoritetit të Përgjithshëm të Argëtimit ka vendosur edhe pagën e egjiptianit, i cili, nëse do të pranonte që të transferohej në Saudi Pro League, do të përfitonte 77 milionë euro në dy sezone. Salah është në sezonin e tij të fundit në Liverpool ku ka shënuar 232 gola në 376 ndeshje.

Ndërron jetë legjenda e futbollit shqiptar Sabah Bizi

Ikona e futbollit shqiptar, Sabah Bizi, ka ndërruar jetë në moshën 79-vjeçare. Prej disa muajsh gjendja e tij shëndetësore ishte përkeqësuar, ndërsa ditën e sotme ka ndërruar jetë. Bizi do të mbahet mend për kontributin e jashtëzakonshëm që ka dhënë. Ai ka fituar shumë tituj me Vllazninë dhe Flamurtarin, ndërsa ka debutuar në moshën 17-vjeçare në futbollin shqiptar. Titullar i Vllaznisë që nga viti 1965 deri në vitin 1968, ndërsa në shumë sezone është vlerësuar edhe si një nga më të mirët e vitit. Bizi ka kontribuar edhe për kombëtaren shqiptare, teksa ka luajtur 15 ndeshje dhe ka shënuar një gol. Debutimi i tij me përfaqësuesen daton më 8 prill të vitit 1967.

Arteta: Jemi për titull

Skuadra e Arsenalit e mundi me rezultat 2-1 Tottenhamin, në derbin e Londrës, duke treguar edhe një herë se është skuadër pretendente për ta fituar titullin kampion. Pas ndeshjes foli trajneri Mikel Arteta, i cili u shpreh i lumtur për paraqitjen e skuadrës. "Jam shumë krenar për ekipin. Mendoj se ishim sensacionalë. A mund të besojmë në titullin e Premierë Ligës? Rezultati na jep mundësinë ta shijojmë çastin. Ne jemi në garë. Ka edhe shumë ndeshje", ka thënë Arteta.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Dervis Bey” Sh.p.k. Mamushë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për pompën e derivateve në Mamushë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 07.03.2025 në ora 09:00 në Sallën e kuvendit komunal të Mamushës do të organizohet debat publik nga Kompania “Dervis Bey” Sh.p.k. Mamushë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën elektronike

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Dervis Bey” Sh.p.k. Mamushë për pompën e derivateve në Mamushë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Roto Recycling” Sh.p.k. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për depon e grumbullimit të letrës dhe plastikës në Obiliq.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 07.03.2025 në ora 11:30 në hapësirat e Sh.f.m.u “Dr.Ibrahim Rugova”, fshati Mazgit, Komuna e Obiliqit do të organizohet debat publik nga Kompania “Roto Recycling” Sh.p.k. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën elektronike

<https://us04web.zoom.us/j/3422360809> ; passwordi: 617875

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Roto Recycling” Sh.p.k. Prishtinë për depon e grumbullimit të letrës dhe plastikës në Obiliq.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Oldisard Zharku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të shkollës së mesme Teknike “Nexhmedin Nixha”.

- Luan Rrustemi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shm Ekonomike “Kadri Kusari”.

- Donjeta Bushati nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e kl. 13 të shkollës së mjekësisë “Hysni Zajmi”.

- Ismet Jkurti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës për punë të kualifikuar QAMO.

- Ardita Cenaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e sh.m Ekonomike “Kadri Kusari”.

- Mirjeta Kryeziu nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e Gjimnazit “Hajdar Dushi”.

- Nazmije Koshi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Kadri Kusari”.

- Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Joni” Sh.p.k. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Fabrikën për prodhimin e betonit në Mleqan, Malishevë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 07.03.2025 në ora 11:00 në hapësirat e SH.M.P. “Lasgush Poradeci”, Kijeve, Malishevë do të organizohet debat publik nga Kompania “Joni” Sh.p.k. Prishtinë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën elektronike

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vckxadVorQT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Joni” Sh.p.k. Prishtinë për Fabrikën për prodhimin e betonit në Mleqan, Malishevë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



